



Pranuar / Dorezuar Prilapeno/Pradato Received/Delivory	03-06-2022	2	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Pror In Pror Pror No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRINSHOC	3254/2022		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.416/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë me Flakron Gashi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.416/2022 të parashtruar nga ankuesi datës 22.04.2022, me adresë banimi: Komuna e Drenasit, kundër organit të punësimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa A.nr.416/2022 e datës 22.04.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, kundër vendimit me numër:569/2022 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së të datës 15.04.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 22.04.2022 me pretendimet ankimore se vendimi i datës 14.03.2022 me numër:436/2022 i nxjerrë nga Kryeshefi Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është në kundërshtim me ligjin material si dhe aktet e brendshme normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 05.05.2022, me numër protokolli 2616/2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendror të Zgjedhjeve,





ndërsa me datën 12.05.2022 me numër protokolli 2764/2022, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 22.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër:569/2022 të Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së të datës 15.04.2022; Ankesën e ankuesit të datës 01.04.2022 të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Sekretariatit të KQZ-së; Vendimin e Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i datës 09.03.2022 me numër:416/2022; Vendimin për caktimin e Ushtruesit të Detyrës e datës 14.03.2022 i nxjerr nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; E-mailin e datës 27.01.2022 dërguar nga ankuesi për Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së; E-mailin e datës 27.01.2022 dërguar nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së për ankuesin; E-mailin e datës 12.05.2022 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të KQZ-së për Këshillin; Shkresën e përgjegjës në kërkesë më privat e lëndës e datës 12.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.05.2022; Akt emërimit të ankuesit i datës 02.07.2019 me numër:684/2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Financa; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt emërimit të nëpunësit civil S.Q i datës 04.02.2019 me numër:64-19-2019; Akt emërimit të nëpunësit civil S.Q i datës 15.07.2011 me numër:863/2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë Komunal Zgjedhor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 02.07.2019 mbanë pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa" në kuadër të Departamentit të Administratës dhe Përkrahjes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 01.04.2022 kundër vendimit të datës 14.03.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me pretendimin ankimore se caktimi i nëpunësit civil S.Q në pozitën e Ushtruesit të Detyrës të Drejtorit të Departamentit të Koordinimit në Teren është bërë në kundërshtim me Rregulloren Nr.04/2017 për Avancimin në Karriere dhe Transferimin e Nëpunësve në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 15.01.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:569/2022 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Kolegji me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar aktin e themelimit të marrëdhënies së punës të nëpunësit civil S.Q dhe ka konstatuar se i njëjti sipas aktit të emërimit të datës 15.07.2011 me numër:863-2011 si dhe Ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 04.02.2019 i njëjtë mbanë pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal Zgjedhor" në kuadër të Departamentit të Operacioneve Zgjedhore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa përmes vendimit të datës 14.03.2022 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është caktuar në pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit të Departamentit të Koordinimit në Teren dhe në bazë të gjeturave rezulton se nuk bëhet fjalë për pozitë në kuadër të



të njëjtit departament ku punon edhe ankuesi, andaj në kuptim të nenit 50 paragrafi 1 të Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "Nëpunësit civilë kanë të drejtë për ankesë kundër vendimit administrativ apo çdo shkelje ose lëshim të rregullave ose procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës", Kolegji konstaton se ankesa e ankuesit është e palejuar ngase nuk mund të provohet se vendimet e kontestuara përmes kësaj ankese kanë ndikuar apo kanë të bëjnë me marrëdhënien e tij të punës i cili sipas aktit të emërimit të datës 02.07.2019 mban pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa" në kuadër të Departamentit të Administratës dhe Përkrahjes të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.nr.416/2022**

**Flakron GASHI**

*Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional*

**Eshref SHABANI**

*Kryetar i Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.